



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:298331
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05727939

Ac.nr.4737/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Naim Meholli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.S nga fshati J....., Komuna e L..... dhe F.M nga P....., të cilët me autorizim i përfaqëson A.H, avokat në Lipjan, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit të cilën e përfaqëson F.M me autorizim, për kompensimin e shujtës, shpenzimeve të udhëtimit dhe pagës jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.750/2019, të datës 13.04.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditësve A.S nga fshati J....., Komuna e L..... dhe F.M nga P....., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.194/19, të datës 03.03.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.194/19, të datës 03.03.2021, ka vendosur si vijon: “ *I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e precizuar e paditësve A.S nga fsh.J..... K.L..... dhe F.M nga P..... si e bazuar, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Lipjanit-DKA, që paditësve të më poshtë shënuar t’ua paguajë dhe atë: 1.Paditësit A.S nga fsh.J..... K.L..... në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, 50% të pagës bazë shumë prej 229.50-€, në emër të kompensimit të shujtës ditore për 668 ditë pune shumë prej 1,336-€ për periudhën nga dt.18.04.2017 deri në vitin 2020, në emër të pagesës për shpenzimet*

e udhëtimit për 668 ditë pune shumë prej 935-€, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e marrjes se aktgjykimit 13.04.2022 e deri te pagesa definitive.2. Padiësit F.M nga P..... në emër të shpërblimit jubilar për 17 vite përvojë pune, 50% të pagës bazë shumë prej 229.50-€, në emër të kompensimit të shujtës ditore për 675 ditë pune shumë prej 1,350-€ për periudhën nga dt.18.04.2017 deri në vitin 2020, në emër të pagesës për shpenzimet e udhëtimit për 675 ditë pune shumë prej 472.50-€, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e marrjes se aktgjykimit 13.04.2022 e deri te pagesa definitive, e të gjitha këto shuma në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II. DETYROHET e paditura që padiëseve t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 514.80- €, si dhe taksën për padi në shumë prej 40- €, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm”.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor, ka paraqitur ankesë e paditura, përmes të autorizuarit të saj, për shkak të shkeljes së dispozitave materiale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljeve esenciale, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovojë si të bazuar ankesën e të paditurës, të prishë aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën ta kthejë në rishqyrtim dhe në vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk kanë paraqitur padiësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se padiësit, përmes të autorizuarit të tyre, me datën 27.12.2019 kanë paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensim i shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit dhe pagës jubilarë, ndërsa me datën 27.01.2022 ka bërë precizimin e kërkesëpadiësë, duke kërkuar që e paditura ta bëjë kompensimin për padiësin A.S për 10 vite përvojë pune nga paga bazë prej 459 € me 50% të saj për pagën jubilarë ta paguajë shumë prej 229.50 €, në emër të shujtës për periudhën prej datës 18.04.2017 deri në vitin 2020 për 668 ditë pune nga 2€ t'ia paguajë shumë prej 1336 € si dhe në emër të pagës së shpenzimeve të udhëtimit në bazë të vërtetimit të N.T “.....” i datës 24.12.2019, bileta e transportit një drejtim kushton 1€ prej fshatit J..... e deri në L.... për 668 ditë në shumë prej 935€ në shumë e përgjithshme prej 2500.70€, ndërsa për padiësin F.M për 17 vite përvojë pune nga paga bazë prej 459 € me 50% të saj për pagën jubilarë ta paguajë shumë prej 229.50 €, në emër të shujtës për periudhën prej datës 18.04.2017 deri në vitin 2020 për 675 ditë pune nga 2€ t'ia paguajë shumë prej 1350 € si dhe në emër të pagës së shpenzimeve të udhëtimit në bazë të vërtetimit të N.T “E.....” i datës 24.12.2019, bileta e transportit një drejtim kushton 0.50€ prej fshatit J..... e deri në L..... për 675 ditë në shumë prej 472.50 €, në shumë e përgjithshme prej 2.052 €, të gjitha këto të llogaritura me kamatë prej 8% e cila do të llogaritet nga data e përfundimit të ekspertizës të

gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësve dhe precizimit të saj, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.750/19 të datës 13.04.2022, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune te e paditura dhe atë: 1). A.S me kontratë pune në Gjimnazin "U....." në L....., mësimdhënës, marrëdhënien e punës e ka filluar nga dt.01.09.2019, 2). F.M me kontratë pune në Gjimnazin "U....." në L....., mësimdhënës, marrëdhënien e punës e ka filluar nga dt.01.09.2017. b) Paditësit në kohën e parashtrimit të kërkesave për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës sipas kontratës kolektive kanë qenë anëtarë të SBASHK-ut, e cila vërtetohet me vërtetimin e lëshuar nga SBASHK-u. c) Lartësia e shpërblimit jubilar dhe shujtës ditore për paditësit, është caktuar në lartësi varësisht nga përvoja e periudhës së punës ashtu që për paditësit A.S dhe F.M, pasi që të dy që kanë pasur përvojë pune mbi 10 vite iu është caktuar shpërblimi jubilar për 50% të një page bazë, ndërsa shujta ditore për paditësit është caktuar në lartësi prej 2€, për ditë të realizuar të mësimin, varësisht prej orëve të mësimin për periudhën 18.04.2017 deri në vitin 2020 për paditësin e parë për 678 ditë pune efektive dhe për paditësin e dytë për periudhën e njëjtë për 675 ditë punë efektive, ndërsa për shpenzimet e udhëtimit lartësia e shpërblimit është caktuar për ditë të realizuar të punës dhe atë për paditësin e parë për 687 ditë pune efektive kurse për paditësin e dytë për 675 ditë pune efektive për periudhën nga data 18.07.2017 deri në vitin 2020. Faktet nën a) gjykata i vërtetoi nga kontrata punës nr. 04-112-813/793 e dt.01.09.2015, e lidhur në mes paditësit A.S dhe të paditurës, nga kontrata punës nr. 04-112-813/1693 e dt.01.09.2017, e lidhur në mes paditësit F.M dhe të paditurës. Faktet nën b), gjykata i vërtetoi me vërtetimet e lëshuara nga SBASHK-u. me nr.1319/7 te dt.02.12.2019 për paditësin e parë dhe me vërtetimin nr.1318/2 te dt.02.12.2019 për paditësin e dytë. Faktet nën c), gjykata i vërtetoi përmes vërtetimit mbi përvojën e punës dhe ditët e prezencës në punë të datës të datës 04.12.2019 dhe vërtetimi nr.4001 dt.03.06.2021, gjeti se paditësi A.S nga viti 2017-2020 ka gjithsej 668 ditë prezente në punë, ndërsa ka përvojë pune 11 vite. Përmes vërtetimit mbi përvojën e punës nr.1739 dt.22.11.2019 dhe vërtetimit për ditët e prezencës në punë nr.399 të datës 03.06.2021, gjykata gjeti se paditësi F.M nga viti 2017-2020 ka gjithsej 675 ditë pune aktive, ndërsa ka përvojë pune mbi 11 vite. Faktin e vendbanimit të paditësit A.S gjykata e vërtetoi nga certifikata e vendbanimit nr B 10256210 dt.20.12.2019 nga e cila u vërtetua se paditësi jeton në fshatin J....., dhe nga kuponin fiskal nr.600021068 i lëshuar nga NT." J....." –me biletë udhëtimi J.....- L..... në vlerë 1€, ndërsa për paditësin F.M nga biletë autobusi dt.24.12.2019 për relacionin P.....-L..... lëshuar nga NTP "E....." në shumë prej 0.50-€ . Faktin e lartësisë së pagës së paditësve, gjykata e vërtetoi përmes listës së pagës së paditësve dhe përmes kontratës së punës, ku përcaktohet lartësia e pagës mujore për secilin nga paditësit, lartësia e pagës bazë për të dy paditësit ishte 442.00€.

Lidhur me mënyrën e vendosjes vendimin e bazoi në nenin 35 paragrafi 5, 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017. Për kamatën ka vendosur konform nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së dhe vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore është bazuar në nenin 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), n) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, se paditësit janë me përvojë pune të pandërprerë mbi 10 vite, që vërtetohet nga vërtetimet për përvojën e punës të paditësit, të lëshuar nga e paditura, nga kontrata e punës për paditësin A.S mësimdhënës me nr.04-112-813/793 dt.01.09.2015 dhe paditësit F.M kontrata me numër 04-112-813/1693 e datës 01.09.2017 e lëshuar nga Drejtoria Komunale Arsimit në Lipjan, ku vërtetohet se paditësit me të paditurën kanë lidhur kontratë pune për pozitën mësimdhënës në Gjymnazin “U.....” në L....., ndërsa nga vërtetimi me nr. prot.4001 dt. 03.06.2021, i lëshuar nga Gjymnazi “U.....” në L....., vërtetohet se paditësi A.S ka përvojë pune 11 vite dhe nga data 18.04.2017 e deri në vitin 2020 ka gjithsej 668 ditë pune e cila vërtetohet nga vërtetimi për ditët e prezencës së punës nr.4001 të datës 03.06.2021 ndërsa për paditësin F.M ka përvojë pune 11 vite dhe nga data 18.04.2017 e deri në vitin 2020 ka gjithsej 675 ditë pune e cila vërtetohet nga vërtetimi për ditët e prezencës së punës nr.399 të datës 03.06.2021, ndërsa lartësia e pagës është vërtetuar nga lista e pagave dhe përmes kontratave të punës në shumën prej 442 € për të dy paditësit. Faktin e vendbanimit të paditësit A.S gjykata e vërtetoi nga certifikata e vendbanimit nr B 10256210 dt.20.12.2019 nga e cila u vërtetua se paditësi jeton në fshatin Janjevë, dhe nga kuponi fiskal nr.600021068 i lëshuar nga NT.” J.....” –me biletë udhëtimi J.....-L..... në vlerë 1€, ndërsa për paditësin F.M nga biletë autobusi dt.24.12.2019 për relacionin P.....-L..... lëshuar nga NTP “E.....” në shumë prej 0.50 €, andaj pretendimet ankimore u refuzuan të pathemelta.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Me nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Në paragrafin 5 të kësaj Kontrate përcaktohet se: *“Punonjësit të kësaj Kontrate përcaktohet se arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70 % të biletave të trafikut urban”*. Me nenin 35 paragrafi 8 pika 3, të KKAK parashihet se: *“Punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, për 30 vjet përvojës së punës në vlerë prej 100% të një page bazë”*, ndërsa, sipas pikës 5 të të njëjtit paragraf: *“Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse”*. Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e lindjes së të drejtës për parashtrim të kërkesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, shpenzimeve të udhëtimit dhe pagës jubilarë, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë së paditësve.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, i të paditurës ndaj paditësve për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit – shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë, pagës jubilarë dhe për shpenzime të udhëtimit, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruerit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për

zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim ushqimit, për ditët e pranisë në punë, shpenzimeve të udhëtimit dhe shpërblimi jubilar i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet e pa themeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, ndër të tjera thuhet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”*, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet e pathemeltë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kamatën është në përputhje me dispozitën e nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së pasi që veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga të lart cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4737/2022, me datë 22.05.2024

Kryetare e kolegjit,
Nora Bllaca-Dula, d.v.